<p>1. Në rastin kur pala vepron e përfaqësuar, organi publik i kryen veprimet procedurale dhe komunikon me përfaqësuesin.</p> <p>2. Organi publik, mund të kërkojë drepëdrejt nga pala kryerjen e një apo disa veprimeve të caktuara procedurale në rastet kur parashikohet shprehimisht me ligj. Në këtë rast, përfaqësuesi i palës duhet të informohet.</p> <p>3. Pala, edhe nëse ka autorizuar një përfaqësues, kur e vlerëson të nevojshme, mund të kryejë personalisht veprime procedurale, të japë deklarata apo të ndërmarrë veprime tjera në procedurën administrative.</p> <p>4. Pala e pranishme, kur përfaqësuesi i autorizuar jep një deklaratë me gojë, mund ta zhvlerësojë apo tërheqë atë, aty për aty.</p>	<p>1. When a party acts through a representative, the public organ shall perform procedural actions and communicate with the representative.</p> <p>2. The public organ may request from the parties to perform one or more procedural actions, when required in accordance with the law. In such case, the parties' representative should be informed.</p> <p>3. Even when represented, when it deems necessary, the party may personally carry out procedural actions or give statements or undertake other actions relevant for the administrative proceeding.</p> <p>4. When the authorised representative makes a verbal statement, the party present may immediately invalidate or revoke it.</p>	<p>1. U slučaju kada stranka deluje zastupljena, javni organ obavlja procedure i saopštava zastupnika.</p> <p>2. Javni organ, može direktno da zahteva od stranke obavlja jedan ili više proceduralnih postupaka u slučaju kada se izričito predviđa zakonom. U ovom zastupnik stranke mora biti upoznat.</p> <p>3. Stranka i ako je ovlastila zastupnika, kad smatra da je to potrebno, može i sama da obavi proceduralni postupaka, da daje izjavu ili preduzme druga delovanja u administrativnom postupku.</p> <p>4. Prisutna stranka, kad ovlašteni zastupnik da usmeno izjavu, može je obezvređiti automatski na licu mesta</p>

<p>KAPITULLI II ORGANI PUBLIK</p> <p>Nënkapitulli 1 Kompetenca</p> <p>Neni 21 Kompetenca lëndore</p> <p>1. Kompetenca lëndore e organit publik përcaktohet me ligj.</p> <p>2. Nëse kompetenca lëndore për një çështje të caktuar nuk përcaktohet shprehimisht nga ligji apo është e pamundur të përcaktohet sipas natyrës të çështjes, organi publik i ngarkuar me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit përkatës material, do të ketë kompetencën lëndore mbi atë çështje.</p> <p>Neni 22 Kompetenca territoriale</p> <p>1. Nëse kompetenca territoriale nuk përcaktohet shprehimisht nga ligji apo akti nënligjor, ajo përcaktohet si vijon:</p> <p>1.1. në një çështje që ka të bëjë me një pronë të paluajtshme apo me një të drejtë reale apo marrëdhënie tjetër</p>	<p>CHAPTER II THE PUBLIC ORGAN</p> <p>Section 1 Competence</p> <p>Article 21 Subject-matter competence</p> <p>1. Subject-matter competence of the public organ shall be determined by law.</p> <p>2. If subject-matter competence is not regulated by law, nor is it possible to determine it by the nature of the matter, the public organ performing supervision over the implementation of the pertinent material law shall be deemed competent in relation to that matter.</p> <p>Article 22 Territorial Competence</p> <p>1. If the territorial competence of a public organ is not regulated explicitly by law or secondary legislation , it shall be determined:</p> <p>1.1. in matters relating to immovable property or to a right or legal</p>	<p>II POGLAVLJE JAVNI ORGAN</p> <p>Pod-poglavlje 1 Kompetencije</p> <p>Član 21 Predmetne kompetencije</p> <p>1. Predmetne kompetencije javnog organa određuju se zakonom.</p> <p>2. Ako određene predmetne kompetencije povodom određenog pitanja nisu određene izričitim zakonom ili je nemoguće odrediti prema prirodi problematike, javni organ je zaduže za nadzor primene dotičnog zakona materijala i imaće predmetnu kompetenciju po tom pitanju.</p> <p>Član 22 Teritorijalne kompetencije</p> <p>1. Ako teritorijalna kompetencija nije izričita zakonom ili podzakonskim aktima, ona se određuje ko u nastavku:</p> <p>1.1. po pitanju nepokretne imovine ili istinskog prava ili drugog pravnog</p>
--	--	--

<p>juridike lidhur me një pronë të paluajtshme – sipas vendndodhjes së pronës;</p> <p>1.2. në një çështje të lidhur me një veprimtari afariste apo profesionale të palës - sipas vendit ku ndodhet selia apo vendi i ushtrimit të veprimtarisë së palës;</p> <p>1.3. në çështje të tjera - sipas vendbanimit të palës. Nëse pala nuk ka vendbanim në territorin e Republikës së Kosovës, kompetenca territoriale përcaktohet sipas vendqëndrimit të përkohshëm të palës. Nëse pala nuk ka vendqëndrim të përkohshëm në territorin e Republikës të Kosovës, kompetenca territoriale do të përcaktohet në bazë të vendbanimit apo vendqëndrimit të fundit që pala ka pasur.</p> <p>2. Në çështjet ku kompetenca territoriale nuk mund të përcaktohet sipas dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni, ajo përcaktohet sipas vendit ku ka lindur apo është shfaqur arsyeja për fillimin e procedurës administrative</p>	<p>relationship related to a piece of immovable property, according to the location of the property;</p> <p>1.2 in matters relating to business or professional activities of the party - according to the place of the party's headquarters or the place where the business is conducted or should be conducted;</p> <p>1.3. in other matters - according to the residence of the party. If the party does not have residence on the territory of the Republic of Kosovo, territorial competence is determined according to the party's temporary residence, and if the party has no temporary residence, according to the place of the last residence or temporary residence on the territory of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. When the criteria above fail to determine territorial competence, it shall be established by considering the place where the reason for the conduct of administrative proceedings arose.</p>	<p>odnosa u vezi nepokretne imovine – mestu na kome se nalazi;</p> <p>1.2. po pitanju u vezi poslovnog ili profesionalnog delovanja stranke – prema mestu na kojem se nalazi sedište ili primenjuje delovanje stranke;</p> <p>1.3 druga pitanja- prema mestu boravka stranke. Ako stranka nema mesto boravka na teritoriji Republike Kosov, teritorijalne kompetencije se određuju prema privremenom mestu stanovanja. Ako stranka nema privremeno mesto stanovanja na teritoriji Republike Kosova, teritorijalne kompetencije određuju se prema odluci poslednjeg mesta stanovanja ili mesta boravka koje je imala stranka.</p> <p>2. Pitanje koje se teritorijalna kompetencijama ne može odrediti prema odredbama stav 1, ovog člana, ono će se odrediti aprema mestu rođenja ili nastajanje razloga za počinjanje administrativne procedure.</p>
--	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 23 Përcaktimi dhe natyra detyruese e kompetencës</p> <p>1. Kompetenca përcaktohet në çastin kur fillon procedura administrative dhe çdo ndryshim faktik apo ligjor i mëvonshëm nuk ka efekt, përveç rasteve kur organi në të cilin procedura është në vazhdim:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. pushon se ekzistuari;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. pushon se pasuri kompetencën.</p> <p>2. Përjashtimisht, nëse një organ publik ka filluar një procedurë administrative pa pasur kompetencën e nevojshme dhe me vonë i është dhënë kjo kompetencë sipas ligjit, ai do të vlerësohet kompetent që nga fillimi.</p> <p>3. Ushtrimi i kompetencës është i detyrueshëm. Përveç sa parashikohet në paragrafin 2 të nenit 25 të këtij Ligji, organi publik apo palët nuk mund të përcaktojnë apo ndryshojnë atë me asnjë mjet.</p> <p style="text-align: center;">Neni 24</p>	<p style="text-align: center;">Article 23 Determination of competence and the mandatory nature of competence</p> <p>1. Competence is determined at the moment when the administrative proceeding begins. Every legal or factual change that might happen later on has no effect, except in cases when the organ, in which the proceeding is on-going,</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. ceases to exist,</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. ceases to be competent, or</p> <p>2. Except, if a public body has initiated an administrative proceeding without having the necessary authority and later this authority has been granted to the public body, it shall be considered competent as from the very beginning.</p> <p>3. The exercise of competence is mandatory. Except as provided under paragraph 2 of article 25 of this Law, the public organ or parties are not authorized to determine or modify it by any means.</p>	<p style="text-align: center;">Član 23 Određivanje i obavezujuće prirode kompetencije</p> <p>1. Kompetencije se određuju od momenta kad počinje administrativna procedura i svaka novonastala činjenična, zakonska promena nema efekat, osim u slučaju kada organ kod kojeg je procedura:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. prestaje da postoji;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. prestaje da ima kompetencije,</p> <p>2. Izuzetka ako je javni organ pokrenuo administrativni postupak bez nadležnosti a kasnije je stekao i te nadležnosti prema zakonu, biće ocenjena ko kompetencije od samog početka.</p> <p>3. Primena nadležnosti je obavezna. Samo ako je predviđeno u stav 2 člana 25 ovog Zakona, javni organ ili stranke ne mogu da odrede ili promene nikakvim sredstvima.</p>
---	---	---

<p style="text-align: center;">Kompetenca në raste urgjente</p> <p>1. Nëse një organ publik kompetent nuk mund të veprojë, apo të veprojë pa vonesë, për shmangien e një dëmi të menjëhershëm, të rëndë dhe të pariparueshëm që mund t'i shkaktohet interesit publik apo të drejtave a interesave juridike të personave, çdo organ tjetër publik, kryesisht apo me kërkesë, është kompetent të ndërmarrë veprimet të domosdoshme për shmangien apo kufizimin aty për aty të dëmit.</p> <p>2. Organi tjetër publik informon pa vonesë organin kompetent për masat e marra si dhe arsyen e ndërhyrjes së tij.</p>	<p style="text-align: center;">Article 24 Competence for urgent actions</p> <p>1. In cases the public organ having the competence is not able to act immediately, to avoid imminent grave and irreparable damage for public interest, rights or legitimate interests of persons, any other public organ, ex officio or upon request, may undertake an urgent action to avoid such damage.</p> <p>2. The other public organ shall without delay inform the competent organ of the measures taken, as well as of the reasons for the intervention.</p>	<p style="text-align: center;">Član 24 Kompetencije u hitnim slučajevima</p> <p>1. Ako kompetentan javni organ, ne može da deluje, ili da deluje bez odlaganja, kako bi se izbegla neposredna, teška šteta i nepopravljiva koje može izazvana javnom interesu ili pravima pravnog interesa lica, svaki drugi javni organ, u glavnome ili na zahtev, kompetentan je da preuzme neophodne mere kako bi se izbegla ili ograničila na licu mesta šteta.</p> <p>2. Drugi javni organ, informiše, bez kašnjenja, kompetentnog organa o merama i razlog njegovog intervenisanja.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 25 Verifikimi dhe konflikti i kompetencës</p> <p>1. Organi publik verifikon kompetencën sipas detyrës zyrtare apo me kërkesë.</p> <p>2. Përveç kur parashikohet ndryshe me ligj, konflikti i kompetencës ndërmjet dy a më shumë organeve publike zgjidhet me marrëveshje unanime ndërmjet tyre.</p> <p>3. Në rast se organet publike në konflikt nuk</p>	<p style="text-align: center;">Article 25 Verification and conflict of competence</p> <p>1. The public organ ex officio or on request by a party shall verify its competence.</p> <p>2. Except when provided otherwise by law, the concurrence of competence shall be resolved by unanimous agreement of the concurrent public organs.</p>	<p style="text-align: center;">Član 25 Provera i sukob kompetencija</p> <p>1. Javni organ proverava kompetencije prema službenoj obavezi ili na zahtev.</p> <p>2. Osim ako je drugačije zakonom predviđeno, sukob kompetencija među dva ili više javna organa rešava se jednoglasnim sporazumom među njih.</p>

<p>arrijnë një marrëveshje, konflikti i kompetencës zgjidhet nga organi i përbashkët epror, që vjen menjëherë më sipër në hierarki dhe që ka kompetenca kontrolli apo mbikëqyrjeje mbi organet në konflikt.</p> <p>4. Organi i përbashkët epror, sipas paragrafit 3 të këtij neni, për konfliktet ndërmjet dy ministrive të ndryshme apo ndërmjet një ministrie dhe një organi qendror në vartësi të kryeministrit, është Qeveria e Republikës të Kosovës.</p> <p>5. Përveç kur parashikohet ndryshe me ligj, në rast se organet në konflikt nuk kanë një organ të përbashkët epror, konflikti i kompetencës zgjidhet nga gjykata kompetente për çështjet administrative.</p> <p>6. Zgjidhja e konfliktit të kompetencës kërkohet nga secili prej organeve në konflikt ose pala, menjëherë me marrjen dijeni të konfliktit.</p>	<p>3. In case they do not reach an agreement, the conflict shall be resolved by the common superior public organ, which has control or supervising organ upon the organs in conflict.</p> <p>4. The common superior organ, referred to under paragraph 3 of this article, in case of conflict between different ministries or between a ministry and a central organ under the subordination of the Prime Minister shall be the Government of the Republic of Kosovo.</p> <p>5. Except when provided otherwise by law, the concurrence of competence in case no common superior organ exists shall be ruled by the competent court for the administrative disputes.</p> <p>6. The resolution of the conflict of competencies is requested by any of the organs involved upon taking cognizance of the latter.</p>	<p>3. U slučaju da javni organi ne postignu sporazum o sukobu kompetencija zajednički nadređeni organ rešava, koji je odmah iznad njih po hijerarhiji i koji ima kompetencije kontrole ili nadzora nad organe u sukobu.</p> <p>4. Zajednički nadređeni organ, prema stavu 3 ovog člana za konflikt među dva različita ministarstva ili među ministarstvo i centralnog organa je u nadležnosti Premijera ili Vlade Republike Kosova.</p> <p>5. Osim kada se drugačije predviđa zakonom, u slučaju da organi u sukobu nemaju nadređenog zajedničkog organa, sukob kompetencija rešava nadležni sud za administrativna pitanja.</p> <p>6. Rešavanje sukoba kompetencije, zahteva se od svakog organ u sukobu ili stranke, odmah da upozna o sukobu.</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;">Nënkapitulli 2 Zyrtari përgjegjës</p> <p style="text-align: center;">Neni 26 Zyrtari përgjegjës për procedurën administrative</p> <p>1. Organi publik kompetent, në një procedurë administrative, vepron nëpërmjet zyrtarit përgjegjës të përcaktuar sipas këtij neni.</p> <p>2. Nëse nuk është përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë, me akt nënligjor apo me rregullat e brendshme administrative të organizimit, titullari i organit publik, cakton paraprakisht, në përputhje me rregullat e organizimit të brendshëm, një njësi përgjegjëse për çdo lloj të procedurës administrative në kompetencë të organit. Vendimi bëhet publik me mjete të përshtatshme, përfshirë ueb-faqen e organit publik.</p> <p>3. Drejtuesi i njësisë përgjegjëse, të përcaktuar sipas paragrafit 2 të këtij neni, mban vetë ose ia delegon një nëpunësi tjetër të njësisë, përgjegjësinë për zhvillimin e procedurës administrative (në vijim: “zyrtari përgjegjës”). Drejtuesi i njësisë</p>	<p style="text-align: center;">Section 2 Responsible Official</p> <p style="text-align: center;">Article 26 Responsible official for the administrative proceeding</p> <p>1. A competent public organ shall act in an administrative proceeding through the responsible official assigned in accordance with the rules provided in this article.</p> <p>2. If not determined directly by special law, by secondary legislation, or by the internal administrative rules of organization, the head of public organ shall preliminarily determine, in accordance with the rules on the internal organization, a responsible unit for each type of administrative proceeding under its competence. The decision is made public by appropriate means including website of the public organ.</p> <p>3. The head of the responsible unit, determined as provided by paragraph 2 of this article, assignsto himself or delegates toanother official within the unit the responsibility to conduct the administrative</p>	<p style="text-align: center;">Pod. Poglavlje 2 Odgovorni službenik</p> <p style="text-align: center;">Član 26 Odgovorni službenik za administrativni postupak</p> <p>1. Kompetentni javni organ, u administrativnom postupku, deluje pomoću odgovornog službenika određenog prema ovom članu.</p> <p>2. Ako nije direktno određen posebnim zakonom, podzakonskim aktima ili unutrašnjim administrativnim uređenjem organizacije, rukovodilac javnog organa, prethodno, će odrediti, u skladu sa pravilima unutrašnjeg organizovanja, jedinicu za svaku vrstu administrativne procedure u nadležnosti organa. Odluka se iznosi javno putem odgovarajućih sredstava, obuhvatajući i web-stranicu javnog organa.</p> <p>3. Rukovodilac odgovorne jedinice, određen prema stav 2 ovoga člana, sam vodi ili delegira drugog službenika jedinice, odgovornost za odvijanje administrativne procedure (u nastavku: “odgovorni</p>
---	---	---

përgjegjëse, prezumohet të jetë zyrtar përgjegjës, deri në caktimin e një zyrtari tjetër përgjegjës sipas këtij paragrafi.

4. Organi kolegjal mund t'ia delegojë njërit nga anëtarët e tij detyrën që të kryejë procedimin administrativ dhe të marrë vendimin, nëse kjo parashikohet shprehimisht me ligj të veçantë. Në këtë rast, anëtari i ngarkuar vepron si zyrtar përgjegjës dhe vë në dijeni organin kolegjal mbi rezultatet e procedurës administrative, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.

Neni 27
Përgjegjësia për procedurën dhe vendimmarrjen

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, zyrtari përgjegjës zhvillon procedurën administrative, vendos për çështjen, e nënshkruan vendimin si dhe siguron njoftimin e palës.

2. Nëse, në dispozitat ligjore, parashikohet se vendimi përfundimtar merret dhe nënshkruhet nga një zyrtar tjetër i organit publik, i ndryshëm nga zyrtari përgjegjës, ky i fundit zhvillon procedurën

proceeding (hereinafter referred to as "responsible official"). Head of responsible unit is presumed to be the responsible official until such responsibility is assigned to another official, as per this paragraph.

4. The collegial public organ may delegate to one of its members the duty to conduct administrative proceeding and decide if that is explicitly stipulated by law. In such a case, the authorized member shall act as responsible official and shall inform the collegial organ about results of the administrative proceeding.

Article 27
Responsibility for the proceeding and the decision

1. If not provided otherwise by law, the responsible official conducts the proceeding, decides on the case and signs the decision, as well as ensures the notification to the party.

2. If the legal provision provides that the final decision is taken and signed by an official of the public organ other than the responsible official, the latter conducts the

službenik"). Rukovodilac odgovorne jedinice, pretpostavlja se da bude odgovorni službenik, do određivanja drugog odgovornog službenika prema ovom stavu.

4. Kolektivni organ može delegirati svom članu obaveze za obavljanje administrativne procedure i da donese odluku ako se ovo izričito zahteva posebnim zakonom. U tom slučaju, zaduženi član deluje kao odgovorni službenik i upoznaje kolegijalni organ o rezultatima administrativne procedure, osima kada je to drugačije predviđeno.

Član 27
Odgovornost o proceduri i donošenje odluke

1. Jedino ako drugačije predviđeno zakonom, odgovorni službenik sprovodi administrativni postupak, odlučuje postupku, potpisuje odluku kao i obezbeđuje obaveštavanje stranke.

2. Ako, se u pravim odredbama, predviđa da konačnu odluku donosi i potpisuje drugi određeni službenika javnog organa drugačije od odgovornog službenika, ovaj

<p>administrative, përgatit një raport me shkrim, në të cilin paraqet një përmbledhje të procedurës së kryer si dhe formulon projekt-aktin apo kontratën administrative dhe ia paraqet atë për miratim dhe nënshkrim zyrtarit tjetër të përcaktuar nga ligji apo akti nënligjor.</p> <p>3. Nëse zyrtari tjetër nuk është dakord me projekt-aktin/kontratën e propozuar, ai është përgjegjës për hartimin apo zëvendësimin e projekt-aktit/kontratës administrative dhe nënshkrimin tij/saj. Raporti dhe projekt-akti/kontrata e propozuar nga zyrtari përgjegjës bëhet gjithashtu pjesë e dosjes së çështjes.</p> <p style="text-align: center;">Neni 28 Ndalimi i nëndelegimit dhe autoriteti i delegatesve</p> <p>1. Zyrtari tjetër i përmendur në paragrafin 3 të nenit 26, apo anëtari i ngarkuar nga organi kolegjal i përmendur në paragrafin 4 të nenit 26 të këtij ligji, që caktohen si zyrtarë përgjegjës për procedurën, nuk mund të delegojnë më tutje.</p> <p>2. Caktimi i njësisë përgjegjëse dhe</p>	<p>proceeding, prepares a written report summarizing the course of the proceeding and presents it together with a draft administrative act or an administrative contract respectively to the official authorised to sign the decision.</p> <p>3. If the other official does not agree with the draft administrative act and administrative contract respectively, he/she is responsible to amend or replace the proposed decision The first draft proposed by the responsible official shall be included in the case file.</p> <p style="text-align: center;">Article 28 Exclusion of sub-delegation and the power of delegators</p> <p>1. The other official referred to in paragraph 3 of article 26 or the authorized member of the collegial body referred to under paragraph 4 of article 26 of this Law cannot delegate further.</p>	<p>poslednji odvija administrativni postupak, priprema pismeni izveštaj u kojem predstavlja sažetak završene procedure kao i formuliše projekat akta ili administrativni ugovor i dostavlja na usvajanje i potpisivanje drugom službeniku određen zakonom ili podzakonskim aktima.</p> <p>3. Ako drugi službenik nije saglasan sa projektom predloženim ugovorom, on je odgovoran za izradu ili zameni administrativnog akt-projekta/ugovora odnosno njegovo potpisivanje. Izveštaj i predloženi akt-projekat/ugovor od strane odgovornog službenika postaje takođe deo dosijea tog pitanja.</p> <p style="text-align: center;">Član 28 Zabrinjavanje pod-delegiranje i autoriteta delegiranih</p> <p>1. Drugi službenik spomenut u stav 3 člana 26 ili zaduženi član od strane kolegijuma pomenutog organa u stav 4 član 26 ovoga zakona koji određuje kao odgovorne službenike za procedure ne može dalje da delegira.</p>
---	--	--

<p>delegimi, sipas nenit 26 të këtij Ligji, do të përfundojnë me shfuqizimin e aktit të caktimit gjegjësisht delegimit në të njëjtën mënyrën sikurse është bërë caktimi apo delegimi.</p> <p>3. Titullari i organit, drejtuesi delegues i njësisë përgjegjëse gjegjësisht organi kolegjal delegues mund të nxjerrin udhëzime të detyrueshme për zyrtarin përgjegjës, lidhur me zbatimin e kompetencave të deleguara.</p> <p style="text-align: center;">Nënkapitulli 3 Përjashtimi nga procedura administrative</p> <p style="text-align: center;">Neni 29 Rastet e përjashtimi nga procedura</p> <p>1. Një nëpunës nuk duhet të përfshihet në një procedurë administrative, nëse ka një interes personal direkt apo indirekt në çështjen në fjalë, në mënyrë të veçantë kur ndodhet në njërën nga këto situata:</p> <p>1.1. kur me palën, me përfaqësuesin ligjor apo me të autorizuarin e palës, është në gjini të gjakut në vijë të drejtë, kurse në</p>	<p>2. The assignment of the responsible unit and the delegation, pursuant to article 26 of this Law, shall cease by an act of revocation under the same form as the act of assignment or delegation;</p> <p>3. The head of the institution, the delegating head of the responsible unit, and the delegating collegial organ respectively may issue instructions that are mandatory to the responsible official, regarding the exercise of delegated decision-making competences.</p> <p style="text-align: center;">Section 3 Exclusion from the proceeding</p> <p style="text-align: center;">Article 29 Cases of exclusion from proceeding</p> <p>1. An official shall not be involved in any administrative proceeding whenever he has a direct or indirect personal interest in the case in question; this is in particular the case</p> <p>1.1. if he is related to the party, to his representative or authorized</p>	<p>2. Određivanje odgovorne jedinice i delegiranje prema članu 26 ovoga zakona, završice se upotrebom akta dotičnog određivanje delegiranja na isti način kao što je urađeno određivanje ili delegiranje.</p> <p>3. Titular organa, delegirani upravnik odgovorne jedinice odnosno organ delegiranog kolegijuma može sastaviti obavezujuće uredbe za odgovornog službenika, u vezi implementacija delegiranih kompetencija.</p> <p style="text-align: center;">Pod-poglavlje 3 Izuzete iz administrativnog postupka</p> <p style="text-align: center;">Član 29 Slučaj izuzete iz postupka</p> <p>1. Službenik ne sme biti obuhvaćen u administrativnom postupku, ako ima direktno ili indirektno lični interes po pitanju o kojemu je reč, naročito kad se nađe u neke od ove situacije:</p> <p>1.1. kad sa strankom, zakonskim zastupnikom ili ovlašćenim stranke je u</p>
---	---	---

<p>vijë anësore deri në shkallë të katërt përfundimisht, bashkëshort apo në gjini sipas vjehrrit deri në shkallë të dytë përfundimisht, edhe atëherë kur martesë ka pushuar;</p> <p>1.2. kur bashkëshorti apo partneri bashkëjetues, apo të afërmit e tij deri në shkallë të dytë, kanë një interes personal direkt apo indirekt në çështjen në fjalë;</p> <p>1.3. kur është vetë palë, përfaqësues ligjor apo i autorizuar i palës, apo me palën është kreditor apo bashkëkreditor, debitor apo bashkëdebitor, apo në qoftë se në të njëjtën çështje është dëgjuar si dëshmitar apo si ekspert, apo ka marrë pjesë në procedurë si këshilltar apo avokat i palës</p> <p>1.4. nëpunësi apo personat e parashikuar nga nënparagrafi 1.2. i këtij neni, kanë një interes direkt apo indirekt në një çështje të ngjashme me çështjen në fjalë;</p> <p>1.5. personat e përmendur në nënparagrafin 1.2. të këtij neni, kanë marrë pjesë si ekspertë, dëshmitarë, këshilltarë apo avokatë në çështjen në fjalë;</p>	<p>representative, by blood in a direct line, or horizontally to the fourth degree, to his spouse or in-law up to the second degree, even when marriage has been terminated;</p> <p>1.2. his spouse or cohabiting partner or his relatives to the second degree, have a direct or indirect personal interest in the case in question;</p> <p>1.3. the official himself is party, legal or authorised representative of the party or is debtor, co-debtor, creditor or co-creditor with a party has participated as a witness, expert, adviser or lawyer in the case in question;</p> <p>1.4. the official or any person referred to in subparagraph 1.2 of this article has a direct or indirect interest in a case similar to the case in question;</p> <p>1.5. any person referred to in subparagraph 1.2 of this article has participated as a witness, expert, adviser or lawyer in the case in question;</p>	<p>direktnoj vezi po krvnoj liniji, dok sporednim linijama zaključno sa četvrto koleno, suprug ili svekar završno do drugi koleno, čak kad je i braka prestao;</p> <p>1.2. kad suprug ili su-životni partner ili njegov bližnji do drugo koleno, imaju direktno ili indirektno lični interese u vezi pitanje o kojemu je reč;</p> <p>1.3. kada je sama stranka, zakonski zastupnik ili ovlašćena strana, ili je sa strankom poverilac ili ko-poverilac, dužnik ili ko-dužnik, ili ako je povodom istog pitanja bio saslušan kao svedok ili ekspert, ili je učestvovao u postupku kao savetnik ili advokat stranke;</p> <p>1.4. Službenik ili osobe predviđene u pod-stav 1.2 ovog člana imaju direktan ili indirektan interes u vezi slična pitanja o kojim je reč;</p> <p>1.5. osobe spomenute u pod-stav 1.2 ovog člana su učestvovali kao eksperti, svedoci, savetnici ili advokati u vezi pitanje o kojemu je reč;</p>
---	---	--

<p>1.6. ndërmjet nëpunësit apo personave të përmendur në nënparagrafin 1.2. të këtij neni, ka një proces gjyqësor me palët;</p> <p>1.7. nëse është pjesë apo shqyrton si organ epror ankesën e një akti të marrë prej vetë atij, ose nga personat e përmendur në nënparagrafin 1.2 të këtij neni;</p> <p>1.8. nëpunësi ose personat e përmendur në paragrafin 1.2 të këtij neni, kanë përfituar dhurata apo shërbime me një çmim dukshëm me të ulët se vlera e tregut, nga palët në procedurën administrative, përpara ose pas fillimit të procedurës;</p> <p>1.9. me palën, përfaqësuesin apo të autorizuarin e palës, është në marrëdhënie të kujdestarit, birësuesit apo të ushqyesit;</p> <p>1.10. në çdo situatë tjetër, parashikuar shprehimisht me ligj apo që mund të vë në dyshim paanshmërinë e tij.</p>	<p>1.6. a judicial process has been initiated between the officials or persons mentioned in subparagraph 1.2 of this article and the parties</p> <p>1.7. if acting as a superior organ in resolving of an appeal against his own decision or a decision of persons referred to in subparagraph 1.2 of this article;</p> <p>1.8. the official or persons mentioned in subparagraph 1.2 of this article has received gifts or services for a price substantially below market value, from any party before or after the administrative proceeding;</p> <p>1.9. the official is in a foster care, adoptive or alimentary relationship with the party, representative or authorised representative of the party;</p> <p>1.10. any other situation explicitly established by law, or that may cast doubt on his impartiality.</p>	<p>1.6. između službenika i pomenutih osoba u pod-stav 1.2 ovog člana je u sudskom postupku sa strankama;</p> <p>1.7. ako je deo ili razmatra kao nadređeni organ, žalba donetog akta od samog njega ili osoba spomenutih u stav 1.2 ovog člana;</p> <p>1.8. ako je službenik ili spomenuta osoba u pod-stav 1.2. ovog člana dobo poklon ili usluge u vidno niske vrednosti od vrednosti na tržištu, od stranke obuhvaćene u administrativnom postupku pre ili posle otpočinjanje postupka;</p> <p>1.9. sa strankom, zastupnikom ili ovlašćenim stranke je u odnosu staratelja, usvojenog ili hranitelja;</p> <p>1.10. svaka druga situacija, izričito predviđena zakonom ili koja može da dovede sumnju njegovu nepristrasnost.</p>
--	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 30 Deklarimi dhe kërkesa për përjashtim</p> <p>1. Kur gjendet apo dyshon se është në një situatë sipas nenit 29 të këtij Ligji, nëpunësi apo anëtar i organit kolegjal, menjëherë me njohjen e shkakut, tërhiqet nga pjesëmarrja në procedurën administrative dhe njofton eprorin e vet gjegjësisht organin kolegjal.</p> <p>2. Çdo nëpunës që ka dijeni për gjendjen e një nëpunësi tjetër në konflikt interesi sipas nenit 29 të këtij ligji, ka detyrimin të njoftojë organin e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni.</p> <p>3. Pala, gjithashtu, mund të kërkojë përjashtimin e pjesëmarrjes së një nëpunësi apo të një anëtarit të organit kolegjal nga një procedurë administrative, deri në çastin e marrjes së vendimit, duke parashtruar arsyet për të cilat kërkohet përjashtimi.</p>	<p style="text-align: center;">Article 30 Declaration and request of exclusion</p> <p>1. If an official or member of a collegial organ is or is suspect of being in a situation referred to under article 29 of this Law, he shall, immediately after becoming aware of it, withdraw from participating in the proceeding and shall notify his superior or the collegial organ, respectively.</p> <p>2. Any official, who is aware that another official is in conflict of interests according to article 29 of this Law, is obliged to notify the organ provided in paragraph 1 of this article.</p> <p>3. Until the final decision is taken, a party may request the exclusion from participation of an official or member of the panel in administrative proceeding, stating the reasons why the party is requesting such an action.</p>	<p style="text-align: center;">Član 30 Izjava i zahtev za izuzeće</p> <p>1. Kad se nađe ili se posumnja da je u situaciji prema članu 29 ovog zakona, službenik član organa kolegijuma, odmah nakon upoznavanje sa razlogom povlači se iz učešće u administrativnom postupku i obaveštava svog nadređenog odnosno organa kolegijuma.</p> <p>2. Svaki službenik koji je upoznat o situaciji određenog službenika u vezi sukob interesa prema članu 29 ovoga zakona, dužan je da upozna organa predviđenog u stavu 1, ovog člana.</p> <p>3. Stranka, takođe, ima pravo da zatraži izuzeće od učešća određenog službenika ili člana organa kolegijuma iz administrativni postupak, do momenat donošenje odluke, iznoseći razloge zbog koje se zahteva izuzeće.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 31 Vendimmarrja dhe efektet e përjashtimit</p> <p>1. Eprori apo organi kolegjal, që ka marrë dijeni për një rast të përjashtimit sipas nenit 30 të këtij Ligji, vendosin brenda 5 ditëve</p>	<p style="text-align: center;">Article 31 Decision and effects of expelling</p> <p>1. The superior or the collegial organ who has become aware of a case of exclusion, as</p>	<p style="text-align: center;">Član 31 Donošenje odluke i efekti izuzeća</p> <p>1. Nadređeni ili organ kolegijuma, koji je upoznat o slučaju ut z izuzeće prema članu</p>

<p>nga marrja në dijeni të rastit, gjegjësisht nga parashtrimi i kërkesës nga pala.</p> <p>2. Në rast të vendimit për përjashtimin, nëpunësi apo anëtari i organit kolegjal zëvendësohet nga një nëpunës apo anëtar tjetër, apo nga vetë eprori, kur ai vendos kështu.</p> <p>3. Në rastin e përjashtimit të titullarit të organit publik, eprori i tij direkt cakton një nëpunës të të njëjtit organ publik për të vazhduar procedurën dhe merr masa për shmangien e çdo konflikti të mëtejshëm.</p> <p>4. Në rastet e përjashtimit të një anëtari të organit kolegjal, organi funksionon si i tillë pa pjesëmarrjen e anëtarit të përjashtuar. Kuorumi dhe vendimmarrja llogaritet pa marrë në konsideratë vendin apo votën e anëtarit të përjashtuar.</p> <p style="text-align: center;">Nënkapitulli 4 Bashkëpunimi administrativ</p> <p style="text-align: center;">Neni 32 Vendimmarrja e përbashkët e organeve publike</p>	<p>per article 30 of this Law, shall issue a decision within 5 days from becoming aware of that or from the submission of the party's request.</p> <p>2. In case of an exclusion decision, the official shall be substituted without delay by another official, or by the superior himself, if the latter so decides.</p> <p>3. In case of exclusion of the head of public organ, his direct superior shall assign an official of the same organ to continue the proceeding and undertake measures to avoid any further conflict.</p> <p>4. In case of exclusion of a member of a collegial organ, the organ shall function as such but without the participation of the excluded member. The quorum and decision making is calculated without taking into account the participation or the vote of the excluded member.</p> <p style="text-align: center;">Section 4 Administrative Cooperation</p> <p style="text-align: center;">Article 32 Joint decision of public organs</p>	<p>30 ovog člana, odlučuje, u roku od 5 dana od saopštavanja za slučaj odnosno od podnošenje zahteva od stranke.</p> <p>2. U slučaju donošenje odluke o izuzeću, službenika ili član organa kolegijuma zamenjuje se sa drugim članom, ili samog nadređenog, ako on tako odluči.</p> <p>3. U slučaju izuzeća rukovodioca javnog organa, njegov direktno nadređeni određuje drugog službenika javnog organa za nastavak postupka zbog izbegavanja svakog daljeg sukoba.</p> <p>4. U slučaju izuzeća člana organa kolegijuma, organ funkcioniše, kao takav bez učešće isključenog člana. Kvorum i donošenje odluke računa ne uzimajući u obzir mesto ili glas isključenog člana.</p> <p style="text-align: center;">Pod-poglavlje 4 Administrativna saradnja</p> <p style="text-align: center;">Član 32 Zajedničko donošenje odluke javnih organa</p>
---	--	--

<p>1. Kur sipas ligjit, dy apo më shumë organe publike vendosin në një procedurë të vetme apo në disa procedura që lidhen me një veprimtari apo rezultat të vetëm, ato përcaktojnë me marrëveshje organin publik që do të nxjerrë aktin administrativ të përbashkët, i cili përfshin edhe vendimin e organit tjetër publik.</p> <p>2. Pavarësisht paragrafit 1 të këtij neni, secili prej organeve të përfshira, vendos vetëm brenda kompetencës përkatëse.</p> <p>3. Përveç kur parashikohet ndryshe me ligj, mosmarrëveshjet ndërmjet dy organeve publike lidhur me paragrafin 1 të këtij neni, zgjidhen sipas nenit 25 të këtij Ligji.</p> <p>4. Nëse me ligj është përcaktuar se, një organ publik vendos pas marrjes më parë të pëlqimit të mendimit apo miratimit të një organi tjetër publik, ky i fundit duhet ta japë mendimin, pëlqimin apo miratimin në një afat prej 15 ditëve prej parashtrimit të kërkesës, përveç kur me dispozita të veçanta parashikohet një afat tjetër.</p> <p>5. Nëse nuk parashikohet ndryshe me ligj, kur organi publik, mendimi, pëlqimi apo miratimi i të cilit kërkohet nuk vepron</p>	<p>1. When in accordance with the law, two or more public organs decide in a single proceeding or in different proceedings that pertains to one single activity, or that shall result in one single outcome, they shall agree, which of them will issue the joint administrative act comprising also the decision of the other public organ.</p> <p>2. Notwithstanding paragraph 1 of this article, each of the involved organs shall decide, in accordance with its own competence.</p> <p>3. Unless otherwise provided by law, the disagreement between the two public organs, related to paragraph 1 of this article, shall be resolved in accordance with article 25 of this Law.</p> <p>4. When in accordance with the law, one public organ shall rule upon prior opinion, consent or approval by another public organ, the latter shall decide and inform the first organ within 15 days following the date of formal request unless another deadline is stipulated by law.</p> <p>5. When the public organ whose consent, confirmation, approval, or opinion is</p>	<p>1. Kad prema zakonu dva ili više javna organa odluče samo o jednoj proceduri ili nekoliko procedura koje su povezane delatnošću ili jedinstvenim rezultatom, oni sporazumom određuju javnog organa koji će doneti zajednički administrativni akt, koji obuhvata i donošenje odluke drugog javnog organa.</p> <p>2. Bez obzira na stav 1 ovog člana, svaki obuhvaćeni organ odlučuje, samo u okviru dotične kompetencije.</p> <p>3. Osim kad se drugačije predviđa zakonom, nesporazum među dva javna organa u vezi stav 1, ovog člana, bira se prema članu 25 ovog zakona.</p> <p>4. Ako je zakonom određen da javni organ, odlučuje pre dobijanje saglasnost mišljenja ili usvajanje drugog javnog organa, Ovaj zadnji mora dati mišljenje, saglasnost ili usvajanje u roku od 15 dana od podnošenje zahteva, osim kada se posebnim odredbama predviđa neki drugi rok.</p> <p>5. Ako nije drugačije predviđeno zakonom, kad javni organ mišljenje, saglasnost ili</p>
---	---	---

<p>brenda afatit të caktuar në paragrafin 4 të këtij neni, konsiderohet se mendimi, pëlqimi apo miratimi është dhënë dhe është në favor të palës. Në këtë rast, organi publik që nuk ka vepruar brenda afatit dhe organi i tij epror do të njoftohen për vazhdimin e procedurës në bazë të prezumimit të dhënies së mendimit, pëlqimit apo miratimit në favor të palës.</p> <p>6. Organi publik i cili nxjerrë vendim, është i detyruar që në vendimin e tij ta cekë aktin me të cilin organi tjetër publik ka dhënë apo ka refuzuar mendimin, pëlqimin apo miratimin, përkatësisht të cekë se në afatin e përcaktuar organi tjetër publik e ka dhënë ose jo atë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 33 Pikat e vetme të kontaktit</p> <p>1. Kur sipas ligjit dy apo më shumë organe publike janë të përfshira në një procedurë të vetme administrative, të gjithë hapat proceduralë dhe formalitetet e nevojshme duhet të trajtohen nëpërmjet një pike të vetme kontakti.</p> <p>2. Ekzistenca e një pike të vetme kontakti</p>	<p>necessary for issuing a decision, fails to act within the deadline set under paragraph 4 of this article, such organ is considered to have delivered a positive reply, if not specified otherwise by a special law. The public organ that failed to respond in time as well as its superior body are to be notified that the proceeding was continued on the basis of a fictitious positive response.</p> <p>6. A public organ that issues a decision is required to refer in his decision to the act by which the other public organ has given or refused the opinion, consent or approval, or to note its failure to deliver such opinion, consent or approval in time, if that is the case.</p> <p style="text-align: center;">Article 33 Point of single contact</p> <p>1. When in accordance with the law, two or more public organs are involved in a single proceeding all the procedural steps and formalities shall be dealt with by a point of single contact.</p>	<p>usvajanje, koje se traži ne deluje u vremenski roku određenog u stav 4 ovog člana, smatra se da mišljenje, saglasnost ili usvajanje je dato i u interesu je stranke. U ovom slučaju javni organ kojiije delovao u roku i njegov nadređeni organ biće upoznat o nastavku procedure na osnovu pretpostavke davanje mišljenja, saglasnost ili u interesu stranke.</p> <p>6. Javni organ koji donosi odluku je obavezan da u svojoj odluci napomene akt kojim je drugi javni organ dao ili odbio mišljenje, saglasnost ili usvajanje, odnosno da navede dali je u određenom roku drugi javni organa dao u roku ili ne.</p> <p style="text-align: center;">Član 33 Jedinstvene kontakt tačke</p> <p>1. Kada su prema zakonu dva ili više javna organa uključena u isti administrativni postupak, sve proceduralni koraci i potrebne formalnosti moraju se tretirati.</p>
---	---	--

<p>nuk cenon kompetencën e secilit prej organeve publike si dhe të drejtën e palëve t'i drejtohen dhe komunikojnë drejtpërdrejt me organin publik kompetent.</p> <p>3. Pika e vetme e kontaktit ka këto detyra:</p> <p>3.1. të këshillojë aplikantin, njësoj siç detyrohet të bëjë organi publik kompetent dhe, t'i sigurojë atij informimin dhe ndihmën aktive sipas nenit 11 të këtij Ligj. Kjo përfshinë edhe informatat për mjetet dhe kushtet për qasjen në regjistrat publikë dhe në bazat e të dhënave shtetërore, si dhe për mjetet juridike, në rast mosmarrëveshjeje.</p> <p>3.2. të pranojë kërkesën për nxjerrjen e një akti administrativ apo kryerjen e një akti real, si dhe çdo parashtresë tjetër sipas nenit 77 të këtij Ligji dhe t'ia transferojë ato organit publik kompetent;</p> <p>3.3. të komunikojë me palën, gjatë procedurës për të gjitha kërkesat procedurale, dhe</p> <p>3.4. t'ia bëjë të njohur palës çdo akt apo veprim administrativ, të nxjerrë/kryer</p>	<p>2. The existence of a point of single contact does not affect the order of competence of public organs and the right of the parties to communicate directly with the competent organ.</p> <p>3. The tasks and duties of points of single contact are:</p> <p>3.1. . to advise the applicant in the same way the competent public organ is obliged to, and to provide the information and active assistance in accordance with article 11 of this Law. This includes information on means and conditions for accessing public registers and databases and means of legal remedy against a dispute.</p> <p>3.2. to receive the requests for the issuance of administrative acts or the performance of other administrative actions needed, as well as any other submission as stipulated in article 77 of this Law and forward it to the competent public organ accordingly,</p> <p>3.3. to communicate during the proceeding with the parties about all procedural requirements</p> <p>3.4. to notify the parties any</p>	<p>2. Postojanje jedinstvene kontakt tačke ne preuzima nadležnosti bilo kojeg javnog organa kao i pravo stranaka da se obrate i komuniciraju direktno sa nadležnim javnim organom.</p> <p>3. Jedina kontakt tačka ima ove obaveze:</p> <p>3.1. da savetuje aplikanta kao što se obavezuje da bude javni kompetentan organa i da obezbedi njemu sve informacije i aktivnu pomoć prema članu za 11 ovoga Zakona. Ovo obuhvata informacije o sredstvima i uslovi za pristup javnom registru i bazi državnih podataka , kao i pravnim sredstvima, u slučaju nesporazuma.</p> <p>3.2. da prima zahtev o sastavljanju administrativnog akta ili izvršavanje istinskog akta, kao i svaki drugi podnesak prema članu 77 ovog zakona i da to prenese na kompetentan javni organa;</p> <p>3.3. da komunicira sa strankom, tokom procedure za sve proceduralne zahteve; i</p> <p>3.4. da upozna stranku o svakom aktu ili</p>
---	---	--

